


**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE**

Nr. 1227 Rep.
Nr. 806 Kol.



KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Sot, me daten 10.10.2005(dymije e pese), para meje noterit Dusho Dusha, u paraqiten personalisht shitesi dhe bleresi te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje aksionesh me termat e meposhteme :

SHITES:

1.Asllan Grezda, i biri i Abedinit, i datelindjes 08.03.1933, lindur dhe banues ne Tirane, rruga e Kavajes, pall.7/76, identifikuar me pasaporten Nr.AZ049518, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

BLERESI :

1.Shoqeria "Bushati" shpk, regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin Nr.1503, date 07.08.1994, me Kod Fiskal Nr.3805246, NIPT J61818038J, perfaqesuar nga administrator i saj, Ilirjan Bushati, i biri i Koles, i datelindjes 11.06.1954, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.1995092,

OBJEKTI : Shitja e aksioneve nga ana e Asllan Grezda ne shoqerine "BANKA CREDINS" sha ne masen 1.17 (nje pike shtatembedhjete) perqind dhe blerja e tyre nga ana e Shoqerise "Bushati" shpk.

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria "BANKA CREDINS" sha eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr.28969, date 31.01.2003.

Shoqeria ka nje kapital themeltar te nenshkruar prej 8.164.735(tetemilion e njeqind e gjashtedhjete e katermije e shtateqind e tridhjete e pese) USD qe perfaqeson 100 perqind te kapitalit aksioner, me vlere nominale te nje aksioni 1 (nje)USD.


Me vendimin bashkelidhur te Asamblese se Jashtezakonshme te kesaj shoqerise, eshte vendosur ne menyre unanime nga te gjithë aksioneret e shoqerise, miratimi i shitjes nga aksioneri Asllan Grezda i 1.17 (nje pike shtatembedhjete) perqind te aksioneve, nga 2.66 perqind qe ai zoteron ne kapitalin aksioner te shoqerise "BANKA CREDINS" sha, e cila perfaqeson nje vlere prej 217.241(dyqind e shtatembedhjetemije e dyqind e dyzet e nje) USD, me vlere nominale te nje aksioni 1(nje)USD .Çmim i blerjes per 1.17 perqind te aksioneve eshte 95.762(nentedhjete e pesemije e shtateqind e gjashtedhjete e dy)USD .

Shitesi Asllan Grezda, aksioner i shoqerise "BANKA CREDINS" sha, eshte plotesisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij te lire dhe te plote bleresit, 1.17(nje pike shtatembedhjete) perqind te aksioneve, nga 2.66 perqind te aksioneve qe ai zoteron ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ju

S

Ju



Nga ana e vet bleresi, eshte plotesisht dakord qe te bleje paketen prej 1.17(nje pike shtatembedhjete) perqind te aksioneve qe shitesi zoteron ne kapitalin e shoqerise "BANKA CREDINS" sha.

ÇMIMI I SHITJES SE AKSIONEVE DHE MENYRA E PAGESES.

Vlera e shitjes se aksioneve perkatesisht ne masen prej 1.17(nje pike shtatembedhjete) perqind te aksioneve , do te jete e barabarte me nje vlere prej 95.762(nentedhjete e pese mije e shtateqind e gjashte dhjete e dy)USD vlere kjo me te cilen eshte vleresuar paketa e aksioneve prej 1.17(nje pike shtatembedhjete) perqind.

Pagesa ne shumen e mesiperme prej 95.762(nentedhjete e pese mije e shtateqind e gjashte dhjete e dy)USD eshte bere jashte kesaj zyre dhe ne menyren e pageses per te cilen te dyja palet kane rene dakord.

MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi Asllan Grezda do te zoteroje 1.49 perqind te aksioneve prane Banka "CREDINS" sha, e cila perfaqeson 121.479(njeqind e njetzet e nje mije e katerqind e shtatedhjete e nente),USD, ndersa shoqeria "Bushati" shpk, do te zoteroje 3.52(tre pike pesedhjete e dy) perqind te aksioneve e cila perfaqeson 287.400(dyqind e tetedhjete e shtate mije e katerqind)USD.

KLAUZOLA SHITESI TE KONTRATES

Shpenzimet noteriale dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne 5 kopje origjinale, duke patur te gjitha vlere te njejte.Termat e kontrates pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve te cilet e nenshkruan ate me deshire dhe vullnetin e tyre te plote ne prezencen time.

SHITESI

Asllan GREZDA

BLERESI

SHOQERIA "BUSHATI" SHPK

Administratori

Ilirjan Bushati

